



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 42

Prishtinë, më 7.4.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Lulzim Zeneli, Zulfi Merxha, Naim Maloku, Myrvete Pantina, Heset Cakolli, Ali Lajçi, Berat Luzha, Zef Morina, Dragiša Mirić, Elheme Hetemi.
Mungoi : Selvie Halimi.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : Këshilltarët (Njazi Idrizi, Gjevat Lushi) e ministrit I.Vehapi dhe Sekretari Shefki Zeqiri, nga OSCE Blerim Vela dhe Maria Berishaj.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i amendamenteve për themelimin e Agjencisë së pagesave.
3. Të ndryshme.

Kryesuesi Lulzim Zeneli konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

2. Shqyrtimi i amendamenteve për themelimin e Agjencisë së pagesave

Lulzim Zeneli përshëndeti zyrtarët nga ministria e bujqësisë të cilët njoftuan për pengesën që doli për mosardhje të ministrit Vehapi. Në fillim ai njoftoi se Kryesia e Kuvendit ka miratuar kërkesën e këtij komisioni për të shqyrtuar këtë projektligj me një afat shtesë, ndaj kërkoi nga të pranishmit sqarime rreth kërkesës së këtij komisioni : si mund të inkorporohet agjencia e pagesave në projektligjin për Bujqësi dhe zhvillimin rural, pasi që kjo agjenci bien ndesh me ligjin për financa publike.

Këshilltari **Njazi Idrizi** njoftoi se ministria e bujqësisë shumë saktë është e informuar për kërkesat e këtij komisioni për çka falënderoi shumë, ndërsa për më detalisht njoftoi sekretari **Shefki Zeqiri** i cili tha se ministria e bujqësisë, edhe pse agjencia e propozuar nuk e ka bazën

juridike, mendon që problemi aktual për formimin e një agjencie mund të anashkalohe duke formuar një **divizion për pagesa** ose duke formuar **një nënkod për destinacione të bujqësisë**. Zyra ligjore e ministrisë do të kujdeset që gjatë javës së ardhshme të dërgoi këto propozime edhe në formën me shkrim më detalisht.

Naim Maloku apeloj për mosakomodim të tepërt për shkak të lejimit nga kryesia shqyrtimin e projektligjit me një afat shtesë, ai falënderoi zyrtarët e ministrisë për bashkëpunim dhe njëherit lexoi rekomandimet edhe një herë për të potencuar se ku qëndrojnë pengesat ligjore (duke potencuar faktin kryesor se kjo agjenci paraqitet si një “organizatë publike buxhetore” në kuadër të ministrisë). Për shkak të krijimit të rrethanave të reja të bashkëpunimit, ai ishte i mendimit se tani e tutje komisioni nuk ka nevojë të shkoj në variantin e tërheqjes së tri amendamenteve por të sjelli riformulime në bazë të sugjerimeve që do të propozohen nga MBPZHR deri në fund të javës së ardhshme, ku do të mirën parasysh si vijon :

- emërtimi i saktë i agjencisë apo organit që do të formohet,
- riformulimi i nenit të propozuar nga ky komision :

Pagesa e mjeteve

Pagesa e mjeteve për zbatimin e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural bëhet nga Agjencia e Pagesave për zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural, dhe

- riformulimi i nenit për Agjencinë e pagesave.

Komisioni u pajtua me sugjerimet e dhëna nga Naim Maloku, ndërkaq **Elheme Hetemi** kërkoi sqarime nga zyrtarët e ministrisë se si do të funksionon kjo agjenci, a do të jetë e varur apo e pavarur si dhe sqarime tjera të nevojshme për këtë komision.

Zef Morina theksoi unitetin e komisionit sa i përket agjencisë mirëpo kërkoi angazhimin e ministrisë sa i përket pajtimit të Qeverisë me gjithë këto propozime që bëhen tani në këtë komision, sepse Kuvendi më lehtë do të kishte me vendosur, nëse një organ i tillë do të formohet me pajtimin e Qeverisë.

Myrvete Pantina kishte sugjerim të ngjashëm duke pyetur : divizioni për pagesa ose nënkodi që propozohen nga kjo ministri, a janë propozime të lejuara (apo të diskutuara) nga Qeveria.

Këshilltari **Gjevat Lushi** u përgjigj në pyetjet e bëra duke theksuar se ministria e bujqësisë ka caktuar saktësisht detyrat që i takojnë agjencisë në bazë të planit për zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural, pasi që në kuadër të saj i ka dy të tilla (ajo e ushqimit dhe për pyje), janë përcaktuar synimet për 4-5 vite të ardhshme, janë selektuar projektet, grantet etj të gjitha këto me kontabilitet dhe auditor të caktuar. **Shefki Zeqiri** tha se ligji ekzistues për financa publike pashmangshëm duhet të ndryshohet, ngase një nënkod nuk mund të fitoj statusin juridik të pavarur.

Komisioni falënderoi dhe nxori :

K O N K L U D I M

Zyra ligjore e MBPZHR deri në fund të javës së ardhshme , në bazë të konsultimeve paraprake me MEF, të sjellin këtij komisioni ndryshimet (propozimet) me shkrim sa i përket organit për pagesa që propozohet të formohet në kuadër të ministrisë së bujqësisë.

3. Të ndryshme

Lulzim Zeneli në vazhdim njoftoi anëtarët e komisionit me kërkesën e Kryesisë së Kuvendit që vlen për secilin komision parlamentar lidhur me organet-agjencitë e pavarura që janë themeluar nga Kuvendi dhe që duhet ti raportojnë për punën e tyre sipas ligjit. Lidhur me këto organe komisionet duhet që brenda dy javësh të raportojnë me shkrim Kryesinë. Organe të tilla në fushveprimtarinë e këtij komisioni janë dy, njëra si organ i pavarur, ndërsa tjetra në kuadër të MMPH :

1. **Këshilli për Ujëra**-e themeluar më 4.6.2007 (sipas Ligjit për Ujëra) në kuadër të MMPH dhe
2. **Zyra e Rregullatorit për ujëra dhe mbeturina** si organ i pavarur që është themeluar nga UNMIK-u por që sipas Ligjit nr. 03/L-086 për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2004/49 për veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve të Ujësjiellit, Kanalizimit dhe të Mbeturinave, kompetencat kanë kaluar në Kuvendin e Kosovës (ky ligj është miratuar në Kuvend më 13.6.2008, i shpallur më 15.6.2008 nga Presidenti).

Në vazhdim anëtarët e komisionit sugjeruan mundësinë e mbledhjes së informatave lidhur me këto dy organe, duke propozuar që të ftohen (Lulzim Zeneli, Naim Maloku, Zef Morina) krerët e organeve në fjalë ose të vizitohen (Berat Luzha) selitë e këtyre dy organeve, si dhe përfaqësuesi i ministrisë përkatëse të ftohet. Naim Maloku dhe Zef Morina propozuan edhe pyetësorin që do të bëhet për këto dy organe : pse nuk është funksional organi, pengesat për funksionalizimin e organit në fjalë, pse nuk është raportuar deri tani, si funksionon etj. Ali Lajçi kërkoi që së pari të sqarohen gjërat se kush kujt i jap llogari etj. Dragisha Miriç kërkoi që të ftohet edhe ministri për këtë takim. Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Për takimin e dt. 14.4.2009 të ftohen : Ministri i MMPH me bashkëpunëtorët përkatës sa i përket ujërave si dhe përfaqësuesi i ZRRUM (zyrës së rregullatorit të ujërave e mbeturinave) dhe Këshillit për ujëra, të cilët do të sqarojnë në komision funksionimin e këtyre dy organeve sipas kërkesës nga Kryesia e Kuvendit si vijon :

- përmbushjen e detyrimit ligjor të këtij organi të pavarur për të raportuar në Kuvend,**
- mandati i anëtarëve të bordeve,**
- mënyra e përcaktimit të pagave për anëtarët e organeve të pavarura**

Raporti me rekomandime të komisionit duhet parashtruar brenda dy jave Kryesisë së Kuvendit.

Në vazhdim **Lulzim Zeneli** gjithashtu njoftoi komisionin për gatishmërinë e OSCE për mbështetje rreth monitorimit të ligjeve të miratuara në Kuvend , ndaj kërkoi nga anëtarët që të propozojnë ligjet që meritojnë monitorim, në mënyrë që pastaj grupi raportues do të dal në teren për të monitoruar ligjin në bazë të pyetjeve që do të hartohen në komision.

Naim Maloku propozoi Ligjin për Mbeturina, ngase asnjë ligj nuk ka prioritet më urgjent nëse kemi parasysh ngufatjen e territorit të Kosovës nga mbeturinat e shumëllojshme anekënd.

Lulzim Zeneli ishte i mendimit për Ligjin e Ajrit, mirëpo Naim Maloku tha se kjo pyetje hynë në kuadër të kërkesës së Kryesisë rreth ndotësve potencial (Feronikli, KEK, etj).

Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Ligji për Mbeturina do të monitorohet nga ana e këtij Komisioni duke përgatitur paraprakisht OSCE dokumentin përkatës deri në mbledhjen e ardhshme, kur do të caktohen emrat e grupit raportues.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 15,00, mbledhja e radhës do të mbahet të martën më 14.4.2009.

Kryetari i Komisionit,
Lulzim Zeneli

